



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2012
Nr. ref.: RK246/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI127/11

Parashtruesi

Ardian Hasani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr.
219/2009, të 10 qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ardian Hasani, me vendbanim në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 219/2009, i 10 qershorit 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 18 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, lidhur me vendimin nr. 02/11 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjilanit me të cilin është shuar vendi i punës së parashtruesit të kërkesës dhe i njëjti është larguar nga puna.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 tetor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
6. Më 7 tetor 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 127/11, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. 127/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Robert Carolan (kryesues), 2. Almiro Rodriguez (anëtar) dhe 3. Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).
7. Më 18 janar 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Komunën e Gjilanit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve në procedurë administrative

9. Parashtruesi i kërkesës, më 30 mars 2005 ka lidhur kontratë të punës me nr. 02/111/272 me Kuvendin Komunal të Gjilanit, me kohëzgjatje prej 1 janarit 2005 deri më 31 dhjetor 2006, në vendin e punës "Zyrtar për përcjellje" në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.
10. Më 4 janar 2007, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Kryeshefi Ekzekutiv nxori vendimin nr. 02/11 për mospërtëritje të kontratës së punës, bazuar në Vendimin nr. 02/7001, të 13 shtatorit 2006, sipas të cilit ishte shpërbërë Sektori i Inspeksionit dhe rrjedhimisht të punësuarit në atë shërbim ishin transferuar në drejtoritë përkatëse komunale. Vendi i punës "Zyrtar për përcjellje", siç thuhet në vendim ishte shuar për arsye se nuk "kishte kushte bazë për ekzistimin e këtij vendi të punës."
11. Më 10 prill 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), pas ankesës se ushtruar nga parashtruesi, nxori Vendimin me nr. 02/77/2007, me të cilin e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit, anuloi Vendimin Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11, të 4 janarit 2007, si vendim i organit punëdhënës i cili nuk ishte kompetent për vendosje dhe e obligoi ushtruesin e detyrës të Kryeshefit

Ekzekutiv, që në afat prej 10 ditësh ta shqyrtojë vendimin e lartshënuar dhe të bie vendim meritore lidhur me këtë çështje. Ky vendim ishte përfundimtar në procedurën administrative kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa.

12. Më 22 qershor 2007, u.d i Kryeshefit Ekzekutiv në procedurë të përsëritur e ka shuar serish vendin e punës - Zyrtar për përcjellje, që ishte në kuadër të Departamentit të Ekzekutivit, ish-sektorit të Inspeksionit. Më 26 qershor 2007, Komuna e Gjilanit e njoftoi KPMSHC dhe parashtruesin lidhur me këtë vendim.

Përmbledhje e fakteve në procedurë gjyqësore

13. Parashtruesi i kërkesës, pasi që kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative, ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale të Gjilanit kundër Komunës së Gjilanit, me të cilën e ka kontestuar vendimin e u.d. të Kryeshefit Ekzekutiv lidhur me shuarjen e vendit të punës dhe largimin e tij nga puna.
14. Më 14 korrik 2008, Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktgjykimin C. nr 540/07, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, anuloi Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11 dhe 02/10, të 4 janarit 2007, si dhe e obligoi të paditurën, Komunën e Gjilanit, që ta kthejë në punë parashtruesin me të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës, duke filluar nga 1 janari 2007.
15. Më 18 korrik 2008, Komuna e Gjilanit përmes përfaqësuesit të saj ushtroi të drejtën e ankesës kundër Aktgjykimit C. nr 540/07 të 14 korrikut 2008, të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, me propozimin për anulimin e këtij vendimi.
16. Më 26 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut në Gjilan nxori Aktgjykimin Ac. nr 328/2008, refuzoi si të pa bazë ankesën e ushtruar nga përfaqësuesi i Komunës së Gjilanit dhe vërtetoi Aktgjykimin C. Nr. 540/07 të Gjykatës Komunale të Gjilanit, të 14 korrikut 2008. Komuna e Gjilanit, e pakënaqur me këtë aktgjykim, ka ushtruar revizion në Gjykatë Supreme të Kosovës.

Faktet në procedurë përmbartimore

17. Më 5 janar 2009, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e kreditorit, parashtrroi kërkesë për ekzekutimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, në Gjykatën Komunale të Gjilanit, pasi që Gjykata e Qarkut si shkallë e dytë e kishte refuzuar ankesën e ushtruar nga Komuna e Gjilanit.
18. Më 12 janar 2009, Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktvendimin E. nr. 1/2009, me të cilin e aprovoi propozimin e parashtruesit për lejimin e ekzekutimit të Aktgjykimit C. nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, lidhur me kthimin e tij në vendin e punës.
19. Më 22 janar 2009, Komuna e Gjilanit parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, për faktin se e njëjta kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe ishte në pritje të vendimit.
20. Më 26 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Gjilan e hodhi poshtë kërkesën e Komunës së Gjilanit për shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009.
21. Komuna, e pakënaqur me vendimin e Gjykatës Komunale të Gjilanit, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me propozim për prishjen e Aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009 dhe shtyrjen e ekzekutimit derisa Gjykata Supreme të vendoste lidhur me revizionin.

22. Më 16 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktvendimin Ac. nr. 107/09, e hodhi poshtë si të pabazë propozimin e Komunës së Gjilanit për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, si dhe kërkesën për anulimin e këtij vendimi. Pasi që kjo gjykatë, si instancë përfundimtare në procedurë përmbarimore, kishte hedhur poshtë propozimin e Komunës për shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit të shkallës së parë E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, parashtruesi i kërkesës me pas bëri propozim në Gjykatën Komunale të Gjilanit për kompensimin e të ardhurave të humbura personale.
23. Më 28 korrik 2010, Gjykata Komunale e Gjilanit, sipas propozimit të parashtruesit për kompensimin e të ardhurave personale, nxori Aktgjykim C. nr. 278/07 lidhur me këtë çështje dhe e obligoi Komunën e Gjilanit që në emër të pagave t'ia bëjë kompensimin e të ardhurave personale, sipas llogarisë së ekspertit financiar për periudhën kohore: 1 janar 2007 - 31 dhjetor 2007, për periudhën kohore 1 janar 2008 - 31 dhjetor 2008 dhe për periudhën kohore 1 janar 2009 - 13 maj 2009, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
24. Kundër këtij aktvendimi të Gjykatës Komunale të Gjilanit, më 9 dhjetor 2010, Komuna e Gjilanit në afat ligjor parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

Faktet në procedurë kontestimore

25. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. nr.219/2009, me të cilin e aprovoi revizionin e ushtruar nga Komuna e Gjilanit, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac. nr 328/08, të 21 nëntorit 2011, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Gjilanit C. nr. 540/07, të 14 korrikut 2008, si dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit për anulimin e Vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11 të 4 janarit 2007. Kjo Gjykatë e kishte arsyetuar vendimin e saj duke u mbështetur në faktin se, instancat më të ulëta kishin vërtetuar drejtë gjendjen faktike, por e kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kur kanë vlerësuar se kërkesëpadia e parashtruesit është e bazuar. Gjykata Supreme me tej pohon që, me vet faktin që parashtruesit nuk i është vazhduar kontrata e punës, nënkupton që atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si shërbyes civil në pajtim me nenin 35.1 pika (b) të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të skadimit të kohëzgjatjes së punësimit, andaj rrjedhimisht, ndërprerja e marrëdhënies së punës së parashtruesit ka qenë e ligjshme.

Përmbledhje e fakteve në procedurë administrative, pas procedurave gjyqësore

26. Më 19 korrik 2011, KK në Gjilan, pasi që kishte pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e kishte njoftuar parashtruesin lidhur me të dhe bashkëngjitur me njoftimin ia kishte dorëzuar kopjen e Aktgjykimit Rev. nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011.
27. Më 21 korrik 2011, Kryetari i Komunës, bazuar në aktgjykimin e lartshënuar, bie Rekomandim nr. 02/16-20291, në të cilin thuhet: *“Rekomandohet zyra e personelit që të bëjë ç’kycje nga puna të z. Ardian Hasani i caktuar në detyrë punuese: Mirëmbajtës i Stadiumit të Qytetit, në kuadër të DKRS sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.219/2009 të dt. 10.06.2011”*.
28. Më 25 korrik 2011, Komuna e Gjilanit ia ndërpreu parashtruesit të kërkesës kontratat e punës konform Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.219/2009 të 10 qershorit 2011, me të cilin është miratuar revizioni i ushtruar nga kjo Komunë dhe janë ndryshuar aktgjykimet e instancave me të ulëta sipas të cilave ishte obliguar Komuna

që ta kthej në punë parashtruesin me të gjitha të drejtat e plota që dalin nga marrëdhënia e punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, si më poshtë:
- Neni 49.1 i Kushtetutës;
 - Neni 23 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 21.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës; dhe
 - Nenin 6 i Konventës.
30. Parashtruesi pohon se, Gjykata Supreme, vendosi njëanshëm nga shkaku se nuk mori parasysh faktin që Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Gjilanit kishte marrë vendim për shuarjen e vendit të punës dhe largimin e tij nga puna, përderisa atij i kishte skaduar kontrata më 31 dhjetor 2006 dhe se ai vendim, sipas parashtruesit, është i paligjshëm dhe në kundërshtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.
32. Gjykata Kushtetuese, nga shkresat e lëndës ka vërejtur që parashtruesi nuk i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri, në mënyrë që gjykata të lëshohet në themelësinë e kërkesës, nga arsyet të cilat do t'i përmendim në paragrafët që do të pasojnë në vijim.
33. Gjykata, vëren se, me Vendimin nr. 02/11 të 4 janarit 2007, të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjilanit, parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shuarjes së vendit të punës. Duke qenë i pakënaqur me vendimin e sipërpërmendur, parashtruesi ka ndjekur realizimin e të drejtave të tij përmes procedurave administrative, e më pas ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale të Gjilanit, e cila kishte vendosur për kthimin e tij në vendin e punës. Pasi që edhe shkalla e dytë e kishte vërtetuar si të drejtë Aktgjykimin të shkallës së parë C. Nr. 540/07, të 14 korrikut 2008, parashtruesi ka bërë propozim për përmbarimin e aktgjykimit në fjalë. Komuna e Gjilanit, siç shihet nga shkresat, kishte kundërshtuar përmbarimin por kundërshtimi i së njëjtës ishte refuzuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit. Aktvendimi ishte bërë i formës së prerë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe më pas, Komuna kishte respektuar dhe zbatuar Aktgjykimin C. Nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, dhe Aktvendimin E. nr. 1/2009 të Gjykatës Komunale sipas propozimit të parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07, sipas të cilit Komuna është obliguar që ta kthej parashtruesin në punë, gjë të cilën dhe e ka bërë. Por, më pas, vendimi i shkallës së parë dhe vendimi i shkallës së dytë, janë ndryshuar me Aktgjykimin Rev. nr 219/2009 të Gjykatës Supreme, të 10 qershorit 2011.
34. Gjykata Kushtetuese, vëren se parashtruesi pretendon që Gjykata Supreme ka bërë shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventa ndërkombëtare, kur ka vendosur për anulimin e kontratës së tij me nr. 02/111/272 duke e vlerësuar si të ligjshëm vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv për ndërprerjen e kontratës së punës dhe mos vazhdimin e saj. Duket qartë që, Gjykata Supreme kishte vendosur sipas revizionit të ushtruar nga Komuna e Gjilanit dhe është lëshuar në vlerësimin e Vendimit të

Kryeshefit ekzekutiv nr. 02/11 dhe vendimit të u. d. të Kryeshefit ekzekutiv, lidhur me shuarjen e vendit të punës - Zyrtar për përcjellje, që ishte në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.

35. Gjykata, lidhur me këtë, vlerëson që, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe argumentuar bindshëm pretendimin e tij se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare ka shkelur të drejtat e tij. Gjykata, rikujton se është në juridiksionin e Gjykatës Supreme që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta, detyrë e të cilave është vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike dhe zbatimi së drejtës materiale në pajtim me rrethanat e krijuara të rastit, në mënyrë që të evitohen shkeljet e mundshme të të drejtave të garantuara me legjislacionin në fuqi dhe me Kushtetutë.
36. Në vazhdim, Gjykata thekson se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
37. Gjykata mund vetëm të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, parë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
38. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vijë në përfundim se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).
39. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat e nenit 46 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (b), prandaj, si e tillë është qartazi e pabazuar.
40. Mirëpo, Gjykata, në rastin e parashtruesit ka vërejtur një realitet të ri, i cili është krijuar mes parashtruesit dhe Komunës së Gjilanit, pasi që Komuna është obliguar që ta kthejë parashtruesin në punë në pajtim me Aktvendimin E. nr. 1/2009 të Gjykatës Komonale të Gjilanit, për përmbarrimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07, të 14 korrikut 2008.
41. Duke qenë se parashtruesi ka lidhur kontratë të re të punës me nr. 02 nr. 1029, më 29 dhjetor 2009, i ngarkuar me pozitë - Mirëmbajtës i stadiumit të qytetit të Gjilanit, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës nga 1 janari 2010 deri më 31 dhjetor 2012, i njëjti është dashur që ta kontestoj vendimin e Komunës së Gjilanit lidhur me anulimin e kontratës së re të punës 02 nr. 1029, duke iniciuar kontest punë në gjykatën kompetente kundër Komunës së Gjilanit.
42. Nisur nga ky fakt, del se parashtruesi nuk ka provuar që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sa i përket kontestimit të kontratës së re të lidhur me Komunën e Gjilanit.

43. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesi i kërkesës duhet t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar që të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij deklarohet i papranueshëm.
44. Si përfundim, Gjykata konstaton që kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë në përputhje me kërkesat e nenit 46, 47.2 të Ligjit, rregullit 36.1 (a) dhe 36.2 (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46, nenin 47.2 të Ligjit, rregullin 36.1 (a), rregullin 36.3 (h) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani